



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:238521
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05640826

CAP.nr.811/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit V.H nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.M avokat në Prishtinë, ndaj debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK)-QKUK, objekt i përmbarimit-kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cpc.nr.1320/21, i datës 09.06.2022, me datën 30.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e kreditorit V.H nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë Cpc.nr.1320/21, i datës 09.06.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.1320/21, i datës 09.06.2022 ka vendosur si në vijim:

“REFUZOHET propozimi për lejimin e përmbarimit të kreditorit: V.H nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.M avokat në Prishtinë, si i pabazuar.”

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditori përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që ankesën e kreditorit ta aprovoj si të bazuar, ta shfuqizoj aktvendimin e atakuar dhe ta detyroj debitorin që t’ia paguaj kreditorit borxhin sipas propozimit për përmbarim apo çështjen ta kthej në rivendosje. Po ashtu i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Debitori nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 21.10.2024, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit në bazë të titullit ekzekutiv - vendimit të Inspektoratit të Punës 01NR.21-2559/671, i datës 21.05.2020, më gjerësisht si në propozimin për përmbartim.

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar Cpc.nr.1320/21, i datës 09.06.2022 e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin për lejimin e përmbartimit, më konkretisht sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar se pas shqyrtimit të propozimit për përmbartim dhe analizimit të shkresave të lëndës, gjeti se propozimi për lejimin e përmbartimit duhet të refuzohet si i pabazuar për arsye se, dokumenti përmbartues mbi bazën e të cilit kreditori e ka ushtruar propozimin për lejimin e përmbartimit është i pa përshtatshëm për përmbartim, sepse nga ky dokument përmbartimor nuk dihet periodha dhe shuma të cilën debitori i përmbartimit duhet t'a përmbushë ndaj kreditorit të përmbartimit por, në mënyrë të përgjithësuar është thënë se, obligohet Ministria e Shëndetësisë të bëjë pagimin e shpërblimit jubilar për 10 vjetorin e përvojës së punës në vlerën e 1 page për V.H.

Me nenin 27, par.1 të LPP-së, është rregulluar se një dokument përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim, në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit dhe rrjedhimisht jo çdo vendim gjyqësor është titull ekzekutiv, në kuptimin që të jetë objekt i ekzekutimit të detyrueshëm, e në rastin konkret Vendimi i Inspektoratit të Punës 01 Nr.21-2559/671 të datës 21.05.2020 nuk është i përshtatshëm, sepse nuk i përmban këto elemente.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe Gjykata ankimore i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Gjykata e Apelit gjatë shikimit të shkresave të lëndës, vëren se dokumenti në bazë të t' cilit është bërë propozimi për përmbarim është vendim i inspektoratit të punës dhe se si i tillë parashihet si dokument përmbarimor, për shkak se LPP-së vendimet e organit administrativ i njeh si dokumente përmbarimore, mirëpo përkundër këtij fakti edhe kjo Gjykatë vlerëson se nuk janë përmbushur të gjitha elementet e përcaktuara me dispozita ligjore që të lejohet përmbarimi i dokumentit në fjalë.

Neni 27 i LPP-së, në mënyrë shprehimore parasheh se “*dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bën dokumentin përkatës përmbarimor të papërshtatshëm për përmbarim.

Nga shikimi i shkresave të lëndës, për këtë Gjykatë rezulton të provohet fakti se dokumenti përmbarimor –vendimi administrativ i Inspektoriatit të Punës, Punës 01NR.21-2559/671, i datës 21.05.2020, në dispozitiv të tij nuk e përmban shumën e detyrimit, e që nënkupton se dokumenti në fjalë nuk mund të konsiderohet si i përshtatshëm për tu përmbuar sepse është në kundërshtim me dispozitata e LPP-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.P.nr.811/2023, me datën 30.04.2024

Gjyqtarja
Hidajete Gashi Alaj,d.v.